



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIRANDA F. XHEMALÇE  
ADRESA Bulevardi "Zhan D'Ark",  
Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1  
TEL: 682044339

# KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 680

Nr. koleksioni: 169 //

Tirane më 22/02/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2022053270019935573

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2022053270019935573

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Në Tiranë, sot më date 22.02.2022, para meje Notere MIRANDA F. XHEMALÇE, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Bulevardi "Zhan D'Ark", Pallati 21/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, u paraqit personalisht:

**DHURUES: Julian Memelli**, atësia Gëzim, amësia Mimoza, shtetas Shqiptar, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, me adresë Ali.Pashe.Gucia; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia Bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë, lindur më 02/09/1985, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036618469 dhe nr. personal I50902076J, regjistruar si person juridik me nipt M11815028I, me seli Tiranë, Rruga e Kavajes Buka sha.

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Dhuruesi")*

**PRANUES I DHURIMIT: Mamica Jançe**, atësia Miti, amësia Erjeta, shtetase Shqiptare, lindur në Pogradec dhe banuese në TIRANË, me adresë E Dafinave; Nd. 72; H. 6; Ap. 37; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 24/05/1986, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034889776 dhe nr. personal I65524063S, .

*(Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "Përfituesi i dhurimit")*

**Baza Ligjore:** Neni 761, neni 764 (paragrafi i tretë) i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë Neni 62, pika 1, gërma "II", Neni 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Neni 73, pika 1, gërma "ç", pika 2 i Ligjit nr. 9901, datë 14/4/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

### Rrethanat për hartimin e aktit noterial:

Dhuruesi Z. Julian Memelli është ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë tregtare "**Albania Distribution Chemicals**" sh.p.k, të regjistruar më datë 15/06/2021, ku përcaktohej objekti i veprimtarisë në fushën e Tregtimit të kimikateve të ndryshme ...etj Gjithashtu shoqëria është pajisur me numër identifikimi (NIPTM11815028I. Z. **Julian Memelli**, është Administrator i shoqërisë, për periudhën 5 vjecare, gjithashtu është zotëruar i 100% të kuotave, vlerë kapitali 100,00, numri i pjesëve 1, 00, me pjesëmarrje në përqindje %, 100,00 pra zotëruar i plotë dhe i vetëm i kuotave të shoqërisë "Albania Distribution Chemicals" sh.p.k.

Dhuruesi dhe pranuesja e dhurimit (përfituesja) kanë shprehur vullnetin e tyre për të krijuar këtë marrëdhënie kontraktore, Palët figurojnë me gjendje civile "Beqarë". Unë noterja, pasi verifikova identitetin e palëve, vijoj me hartimin e Kontratës së Dhurimit me përmbajtje si më poshtë vijon:

### Neni 1

#### Objekti

Objekti i kësaj kontrate është kalimi nëpërmjet dhurimit i të gjitha kuotave të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "**Albania Distribution Chemicals**" sh.p.k. nga ana e dhuruesit Z. **Julian Memelli**, në cilësinë e Ortakut të Vetëm dhe Administratorit, në favor të pranueses së dhurimit (përfitueses) Znj. **Mamica Jançe**, pa kundërshtim.

1. Dhurimin 100% të vlerës së kapitalit fillestar të z. **Julian Memelli**, ortak i vetëm i shoqërisë me kapital 100%, e barabartë me 1,00 pjesë, me vlerë kapitali 100 (njqind) leke, z.nj. **Mamica Jançe**.



A2022053270019935573

2. Znj. Mamica Jance behet ortake e vetme e shoqerise me kapital ne masen 100%.
3. Te hiqet nga z. Julian Memelli nga pozicioni i administratorit te shoqerise.
4. Te vendoset znj. Mamica Jance administratore e shoqerise per nje afat 5 vjecar, deri ne 20.02.2027.
5. Ngarkohen znj. Mamica Jance per depozitimimin e vendimit ne rregjistrin e vendimeve te shoqerise , ne tatime si dhe ne QKB.

## Neni 2

### Kalimi i të drejtës së pronësisë

Palët janë dakord për kalimin e kuotave nga dhuruesi tek përfituesja, e cila, me plotësimin e kushteve ligjore për fitimin e kuotave, do të jetë zotëruesja e vetme e kuotave të shoqërisë **“Albania Distribution Chemicals” sh.p.k**, pra pronarja e ligjshme.

## Neni 3

### Deklarime dhe garanci

Dhuruesi **Z. Julian Memelli** deklaron dhe siguron pranuesen e dhurimit se:

- Shoqëria **“Albania Distribution Chemicals” sh.p.k**, është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar rregullisht dhe e ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- Shoqëria **“Albania Distribution Chemicals” sh.p.k**, nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;
- Ortaku i Vetëm është pronar i ligjshëm i kuotave dhe ka titull të plotë pronësie;
- Kuotat e dhuruara janë të lira nga çdo barrë siguroese, pengesë, pretendime të të tretëve, kufizime apo pengesa ligjore. Nuk ekziston asnjë garanci apo kontratë shitje kuotash, në lidhje me kuotat e dhuruara;
- Kapitali i shoqërisë është shlyer rregullisht dhe nuk ka detyrime të papërbushura apo të shkelura në lidhje me shlyerjen e kapitalit.

Përfituesja Znj. Mamica Jance deklaron dhe siguron dhuruesin se:

- Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë kontratë dhe nuk ka pengesa ligjore që do të cënonin aftësinë e saj për të nënshkruar.
- Nuk ka asnjë fakt, rrethanë apo informacion, i cili mund të cënojë aftësinë e saj për të ushtruar të drejtat dhe për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave të kaluar nëpërmjet dhurimit.

## Neni 4

### E drejta e parablerjes

Në rast se kuotat e kaluara nëpërmjet kësaj kontrate dhurimi mund të jenë në të ardhshme objekt i shitjes/kalimit/dhurimit/transferimit tek palë të treta, përfituesja do të rezervojë të drejtën e parablerjes ndaj dhuruesit. Kjo nënkupton se përpara kontraktimit me persona të tretë, përfituesja, e cila do të jetë zotëruesja e vetme e kuotave, do të njoftojë fillimisht dhuruesin, në cilësinë e zotëruesit të mëparshëm të kuotave, për të shfrytëzuar të drejtën e parablerjes. Në rast se ky i fundit nuk dëshiron të përfitojë, do t'i komunikojë refuzimin e tij zotërueses së kuotave.

## Neni 5 Të ndryshme



A2022053270019935573

Palët bien dakord që do të zbatojnë me regorizitet detyrimet e tyre ligjore me nënshkrimin e këtij dokumenti.

Kjo kontratë dhurimi zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale apo të shkruara, nëpërmjet palëve.

Në rast se ndonjë prej parashikimeve të kësaj kontrate konsiderohet e pavlefshme apo e pazbatueshme, palët do të bëjnë përpjekje për modifikim në minimumin e nevojshëm për ta kthyer të vlefshme apo të zbatueshme dhe nëse kjo nuk arrihet, parashikimi kontraktor do të menjahet dhe kontrata do të jetë e vlefshme në tërësinë e saj.

Kontrata e dhurimit, si dhe pasoja e zbatimit të saj, rregullohet, interpretohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Cdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim, që ka lindur për shkak të kësaj marrëveshje do të zgjidhet në mënyrë miqësore mes palëve, në rast të kundërt, do të trajtohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më sipër, hartohet ky akt noterial nga unë noterja, në bazë të vullnetit të lirë, të plotë dhe të pavesuar të personave të paraqitur, si dhe në mbështetje të deklarimeve të tyre, të cilëve ju lexua përmbajtja e aktit dhe ju shpjeguan efektet ligjore të tij, dhe pasi deklaruan se e kanë kuptuar dhe pranuar, e nënshkruajnë atë rregullisht në praninë time. Unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

Bashkëlidhur, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:


- Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve
- Kopje e Ekstraktit Historik të Shoqërisë “**Albania Distribution Chemicals**” sh.p.k, nxjerrë nga sistemi elektronik i QKB-së

Ky akt noterial përbëhet nga 3 (tre) faqe dhe lëshohet në 3 (tre) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike, ku njëra prej tyre mbahet në arkivën e Zyrës Noteriale dhe dy kopje u dorëzohen palëve kontraktore.

(Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme).

**DHURUESI**

**PRANUESI I DHURIMIT**



**NOTERE**

*Miranda Xhemalçe*

**NOTERE**  
**MIRANDA XHEMALÇE**  
**TIRANË - ALBANIA**

Tirane me 21.02.2022

V E N D I M

i

Asamblese se Pergjithshme

Date 21.02.2022

Sot me date 21.02.2022 ne seiline e shoqerise tregtare ALBANIA DISTRIBUTION CHEMICALS shpk, ne Tirane u mbajt mbledhja e Asamblese se ortakeve, e thirrur nga administratori i shoqerise z. Julian Memelli, per te diskutuar dhe vendosur mbi rendin e dites si me poshte vijon:

1. Dhurimin e kuatove
2. Ndryshimin e administratorit

Ne perfundim te mbledhjes, asambleja e ortakeve, ne mbeshtetje dhe te statutit te shoqerise dhe legjislacionit ne fuqi,


V E N D O S I:

1. Dhurimin 100% te vleres se kapitalit fillestar te z. Julian Memelli, ortak i vetem i shoqerise me kapital 100%, e barabarte me 1,00 pjese, me vlere kapitali 100 (njqind) leke, z.nj. Mamica Jance.
2. Znj. Mamica Jance behet ortak e vetme e shoqerise me kapital ne masen 100%.
3. Te hiqet nga z. Julian Memelli nga pozicioni i administratorit te shoqerise.
4. Te vendoset znj. Mamica Jance administratore e shoqerise per nje afat 5 vjecar, deri ne 20.02.2027.
5. Ngarkohen znj. Mamica Jance per depozitim e vendimit ne rregjistrin e vendimeve te shoqerise , ne tatime si dhe ne QKB.


Asambleja e Pergjithshme Ortakeve

Ortakui vetem

Julian Memelli



Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,  
"Selvia", Kati V  
TIRANË, SHQIPËRI  
TEL/FAX.:355 4 2420005  
TEL:355 4 2420006  
Email: rbs@roen-al.com




**Regjistri i Barrëve Siguruese**

**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-2022022213949138  
Data e Rezultatit të Kerkimit: 22.02.2022  
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 1:09:49PM  
Lloji i Kerkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-224-2225  
Referenca e Perdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

JULIAN GEZIM MEMELLI  
ALBANIA DISTRIBUTION CHEMICALS SH.P.K.



*Flora Dosh...*